



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 02.02.2026

VENDIM

Nr.2, datë 02.02.2026

**PËR
“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË
PORTABILITETIT TË NUMRIT””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 02.02.2026, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin Rregullores për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 146 i Ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 54/2024);
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.21, datë 7.12.2021.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit pas procedurës së këshillimit publik:
 - a. “Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit”;
 - b. “Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të Projekt-Rregullores për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit”
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 7, datë 12.06.2025, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “Projekt-Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”. Ky dokumenti u hartua dhe u publikua për këshillim publik nga AKEP në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i cili hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar Ligjin 9918/2008.
2. Ligji i ri 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim EECC), dhe përmban disa përcaktime të reja mbi të drejtat e përdoruesve fundorë dhe detyrimet e sipërmarrësve në lidhje me portabilitetin e numrit, të cilat nuk kanë qenë pjesë e Ligjit 9918/2008 ose kuadrit nënligjor përkatës ekzistues (Rregullore nr. 43/2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”), përfshirë:
 - Përcaktimet në pikat 1-3 të Nenit 145 në lidhje me ndërrimin e ofruesit të shërbimit të aksesit në internet të cilat synojnë garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi për përdoruesin fundor në rastet e ndërrimit të ofruesit të shërbimit, që ky process të kryhet brenda një kohe sa më të shkurtër dhe mungesa e shërbimit për përdoruesin fundor gjatë këtij procesi të mos jetë më e gjatë se një ditë pune;
 - Përcaktimet në pikën 5 të nenit 145, që një përdorues fundor ruan të drejtën për portimin e numrit të një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës ekzistuese me operatorin/ofruesin dhënë, përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dorë nga kjo e drejtë.
 - Përcaktimet në pikën 12 të nenit 145, në lidhje me detyrime për procesin e portimit dhe për operatorët e rrjetit të aksesit apo faciliteteve të tyre që përdoren nga ofruesi dhënë apo marrës ose nga të dy bashkë, të cilat janë të aplikueshme në rastet kur sipërmarrësit ofrojnë shërbimet e komunikimit zanor duke përdorur rrjetin e një operatori/sipërmarrësi tjetër. Këto përcaktime mund të jenë të aplikueshme në rastet e MVNO-ve për shërbimet celulare

(MVNO përdor rrjetin e aksesit të MNO-së) ose ofruesit e shërbimit të telefonisë fikse nëpërmjet rrjetit të aksesit të një operatori operatori/sipërmarrësi tjetër fikse, me/ose pa detyrime për FNT për LLU (local loop unbundling);

- Përcaktimet në pikën 15 të Nenit 145 në lidhje me detyrimet e operatorit dhënës/ofruesit transferues për rimbursim, sipas kërkesës, të konsumtarorëve për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim;
 - Përcaktimet në pikën 17 të nenit 145, dhe pikat 1/c/ii dhe 1/c/iii të Nenit 180 të ligjit 54/2024, në lidhje me informimin e pajtimtarit për të drejtat e portimit dhe të kompensimit dhe informacionin që duhet të përmbajë kontrata e ofrimit të shërbimit/pajtimit për të drejtën pajtimtarit për kompensim dhe rimbursim për rastet e vonesave ose abuzimeve gjatë procesit të ndërrimit të ofruesit të shërbimit, si dhe informacion në lidhje me procedurat përkatëse, si dhe për rimbursimin e krediteve të mbetura për shërbimet me parapagim.
3. Dokumenti për këshillim publik “*Projekt-Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*” përmbante propozimin e AKEP për projekt-rregulloren e re të portabilitetit të numrit që do të zëvendësojë rregulloren aktuale të portabilitetit (*Rregulloren 43/2016*) me qëllim reflektimin e përcaktimeve të reja ligjore në lidhje me portabilitetin e numrit të referuara më sipër, si dhe adresimin e problematikave të evidentuara në vitet e fundit në lidhje me refuzimet e kërkesave për portim të numrit celular.
4. Dokumenti “*Projekt-Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”, i miratuar me VKD nr.7, datë 12.06.2025, u publikua në faqen e internetit të AKEP-it më datë 18.06.2025, dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 18.07.2025. Në përfundim të procesit të këshillimit publik në AKEP depozituan komente palët e interesuara si më poshtë:
- Sipërmarrësi One Albania sh.a., me shkresën Nr.1654 Prot., datë 17.07.2025 (Ref.AKEP: Nr.1146 Prot, datë 17.07.2025);
 - Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., me shkresën me referencë LEA/055/LR.EM.EK, datë 18.07.2025 (Ref.AKEP: Nr. 1146/1 Prot, datë 18.07.2025).
- AKEP pas përfundimit të procesit të këshillimit ka zhvilluar dy takime më datat 12.09.2025 dhe 16.12.2025, me qëllim diskutimin dhe qartësimin ndryshimeve të propozuara të rregullores dhe komenteve të dërguara nga palët e interesuara, përfshirë aspektet teknike dhe operacionale me dy operatorët celularë si dhe me operatorin e CRDB (Data Baza Qendrore e Portabilitetit të Numrit)
5. Kuvendi i RSH nëpërmjet Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP për vitin 2024, ka rekomanduar që AKEP gjatë vitit 2025, ndër të tjera: (3)*Të marrë masat e nevojshme për rishikimin e rregullores “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” bazuar edhe në përcaktimet e reja ligjore të ligjit nr. 54/2024, që lidhen me këtë proces, për të bërë të mundur përmirësimin e procesit të portimit, duke siguruar që të jetë një proces i thjeshtë, efektiv dhe që mbron të drejtat e përdoruesve fundorë.*

6. AKEP pas vlerësimit të komenteve të palëve të interesuara dhe takimeve të zhvilluara pas këshillimit publik për dokumentin “*Projekt-Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*” së nxjerrë në këshillim publik ka përgatitur dokumentat e mëposhtëm:
- “*Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*” që përbën dokumentin përfundimtar pas procesit të këshillimit publik, si dhe
 - “*Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të Projekt- Rregullores për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”, që përmban komentet e palëve të interesuara gjatë procesit të këshillimit publik të Projekt-Rregullores si dhe qëndrimet e AKEP për komentet.
7. Dokumenti “*Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”:
- është një dokument i rëndësishëm rregullator i përgatitur nga AKEP në kuadër të hartimit të akteve nënligjore përkatëse të nevojshme për zbatimin e Ligjit 54/2024 dhe;
 - është përgatitur pas procesit të këshillimit publik duke marrë në konsideratë komentet e palëve të interesuara;
 - reflekton përcaktimet e reja të Ligjit 54/2024 (Neni 145) si dhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të RSH për AKEP në lidhje me portabilitetin e numrit;
 - nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të Neneve 126, 145 dhe 146 të Ligjit 54/2024;
8. Dokumenti “*Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*” përbën një element të rëndësishëm të kuadrit rregullator për zbatimin e Ligjit 54/2024, që mundëson një mbrojtje më të mirë të konsumatorëve/përdoruesve fundorë të shërbimit publik telefonik/komunikimeve elektronike nëpërmjet përmirësimit të procesit të portimit, për të siguruar një proces të thjeshtë dhe efektiv të portimit të numrit, si dhe një mjedis më konkurrues në treg midis operatorëve .

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP,

VENDOSI:

1. Të miratojë:
 - a. *Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit*”, dhe
 - b. “*Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të Projekt- Rregullores për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”sipas dokumentave bashkëlidhur;
2. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuar në pikën 1 të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP: www.akep.al.

3. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka